



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË KORÇË**

**Nr. 134 Prot**

**Korçë më 24.06.2022**

**Lënda :** Njoftim mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në pozicionin “Specialist It dhe Punonjës i Marrëdhënieve me Publikun dhe Mediat”

**Drejtuar :** Këshillit të Lartë Gjyqësor

Në zbatim të Ligjit Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit Nr.622 datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor" si dhe shpalljen nr.110/1 datë 08.06.2022 të Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Korçë, ju njoftojmë se:

Në përfundim të verifikimit paraprak, për përmbushjen e kriterëve, në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele në pozicionin “Specialist It dhe Punonjës i Marrëdhënieve me Publikun dhe Mediat”, nuk u paraqit asnjë kandidaturë.

Procedura e lëvizjes paralele mbyllet për mungesë aplikimi dhe vendi vakant është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

**Kancelar**

**Aleksandër Dino**